

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7089
E premte, 12 janar 2024
Çmimi 0.50

ShBA-ja pranon kërkesën
e Kosovës për blerjen e
raketave kundërtankeve



Ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
 [facebook.com
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



INTERVISTË EKSKLUZIVE me Bardhyl Mahmutin: Si u hoq cilësimi i UÇK-së si "organizatë terroriste"? (21)

PËRFUNDIMI I LUFTËS NË KOSOVË DHE TRANSFORMIMI I LPK-së

FAC 4-5



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së njëzet e një, ka folur përfundimin e luftës në Kosovë dhe për transformimin e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Ai ka theksuar se më 26

qershor 1999 u votua për shndërrimin e LPK-së në parti politike. "Pas këtij vendimi, më 4 korrik 1999 u themelua Partia e Bashkimit Demokratik, ndërkaq më 7 korrik u formuan organet drejtuese të saj", ka bërë me dije Bardhyl Mahmuti, i cili ka dhënë edhe sqarime për komunikatën e lëshuar nga qyteti Aarau i

Zvicerës, në të cilën theksohej se LPK-ja nuk ka asgjë të përbashkët me Partinë e Bashkimit Demokratik. Gjithashtu, Bardhyl Mahmuti ka folur edhe për reagimet kur dikush përmendte termin "marionetë" dhe "spion francez" për ish-udhëheqësin e Drejtorisë Politike të UÇK-së, Hashim Thaçi

KRYEMINISTRI I IRLANDËS: ASOCIACIONI TË THEMELOHET, POR JO TË KRIJOHET NJË MIKRO-SHTET

F. 3



RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqishti - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk Mob: +377 44 501289

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRINCESHA GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

OPINION

MOS VAJTONI PËR ATA QË
PO IKIN, POR PYESNI VETEN
ÇFARË PO BËNI QË ATA QË
JANË NË KOSOVË TË MBETEN
NË KOSOVË F. 7

Shkruan: Safet GËRXHALIU



AKTUALE



**BUJAR OSMANI: SUNDIMI I LIGJIT
VARET NGA NISJA E NEGOCIAVATE
ME BE-në F. 2**

**90 PËR QIND E PACIENTËVE
TË TRAJTUAR NË KLINIKËN
E ENDOKRINOLOGJISË KANË
QENË ME DIABET F. 6**

EKONOMI



**RRITET TRECTIA ME PAKICË E
PAJISJEVE INFORMATIKE DHE TË
KOMUNIKIMIT F. 8**

**ÇFARË DIHET PËR RASTIN
E FATURAVE FIKTIVE NË ATK? F. 8**

SPORT

**RAMAJ REFUZON KOSOVËN E
SQIPERINE, PRET FTESE NGA
GJERMANIA F. 10**

ShBA-ja pranon kërkësën e Kosovës për blerjen e raketave kundërtankeve

PRISHTINË, 11 JANAR - Shtetet e Bashkuara kanë pranuar kërkësën e Kosovës për të blerë raketë kundërtankeve, "Javelin", i tha ambasadori amerikan në Beograd, Christofer Hill, presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, gjatë takimit të tyre në Beograd më 11 janar. Departamenti Amerikan i Shtetit do ta dërgojë kërkësën e Kosovës në Kongresin Amerikan, me çka fillon procedura zyrtare, thuhet në komunikatën e lëshuar nga Presidencia e Serbisë. Vuçiqi tha se ky lajm është një zhgënjim i madh, por që Serbia, së bashku me ShBA-në, do të punojnë për ruajtjen e raporteve serbo-amerikane. "Për ne është shumë e rendësishme që paqja në rajon të mos prishet dhe që Serbia të vazhdojë të veprojë në mënyrë të përgjegjshme dhe të kontribuojë në stabilitetin në Ballkan", tha presidenti serb. Radio Evropa e Lirë kontaktoi Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës për këtë njoftim, por nga kjo ministri nuk pranuan ta komentonin këtë zhvillim. Gjatë vitit të kaluar kërkesa për sistemin "Javelin" është rritur. Në uebfaqen e prodhuesit të këtyre armëve, "Lockheed



Martin", thuhet se po dyfishojnë prodhimin aktual "nga 2 100 copë në 3 960 copë në vit deri në vitin 2026", siç janë pajtuar në bazë të kontratës së re me ushtrinë amerikane.

Po ashtu, thuhet se 13 shtete në Evropë e përdorin këtë sistem dhe ndër shtetet e fundit janë Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Ukraina u furnizua me sistemet kundërtanke nga Shtetet e

Bashkuara të Amerikës. Deri në fund të titorit 2022, ShBA kishte dorëzuar 8 500 raketë "Javelin" në Ukrainë, ekuivalente me prodhimin e saj katërvjeçar.

Armët e tjera amerikane të FSK-së

Forca e Sigurisë së Kosovës, që është në tranzicion për t'u bërë ushtri, edhe më herët është furnizuar me armë amerikane.

2020, ndërkaq më 2021 qeveria amerikane i dhuroi Kosovës 55 automjete të tipit ASV (Armored Security Vehicle).

Kosova, po ashtu, ka miratuar një vendim për blerjen e dronëve amerikanë, ndërkaq autoritetet e Kosovës kanë paralajmëruar se ushtria e ardhshme do të pajisjet edhe me helikopterë.

Përveç armatimit amerikan, FSK-ja është e pajisur edhe me armë të prodhimit turk, sikurse automjete të blinduara ushtarake dhe dronë.

Më 2028, kur pritet që FSK-ja të shndërrohet ushtri, ajo parashihet t'i arrijë të gjitha kapacitetet operacionale për, siç është thënë, "ruajtjen e sovranitetit territorial të Kosovës, si dhe të qytetarëve, pronave dhe interesave të vendit".

FSK-ja aktualisht ka rrëth 2 500 pjesëtarë. Pas periudhës së tranzicionit, ky numër pritet të rritet në mbi 7 500 dhe të përfshijë pjesëtarë aktivë dhe rezervistë.

Në buxhetin e Kosovës për vitin 2024, të miratuar fundin e vitit të kaluar, Ministrisë së Mbrojtjes i është ndarë buxhet në vlerë prej 153.049.911 eurosh.

Bujar Osmani: Sundimi i ligjit varet nga nisja e negociatave me BE-në

SHKUP, 11 JANAR - Maqedonia e Veriut kërkon nisjen e bisedimeve për anëtarësim evropian që të mund t'i arrijë standartet për sundimin e ligjit në vend, respektivisht ngritjen e sistemit gjyqësor përluftimin e krimtit të organizuar dhe korruptionit. Kështu deklaroi të enjten ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, duke komentuar kritikat e vazhdueshme të diplomatëve perëndimore në Shkup për ndërhyrjen e politikës në punën e gjykatave dhe përpasojë moslufutimin e krimtit të organizuar dhe korruptionit.

Por, Osmani tha se vlerësimi i tij është se "gjyqësori më shumë është i ndikuar nga oligarkët se sa nga politika". "Kjo ndërhyrje është shumë më e rrezikshme se ndërhyrjet politike", u shpreh Osmani duke mos u pajtuar me qëndrimin e diplomatit holandez.

Ambasadori i Holandës në Maqedonië e Veriut, Dirk Jan Kop, gjatë një takimi me kryetarin e Bashkimit Demokratik përligjshëm, Ali

Ahmeti, të mërkurën në Shkup tha se "ndikimi i panevojshëm politik mbi çështjet gjyqësore, është i papranueshëm dhe do të shkaktojë reagim të fortë të Holandës".

Reagimi i ambasadorit të Holandës pasoi një procedurë që po zhvillohet në Këshillin Gjyqësor, organin më të lartë të gjyqësorit në vend përluftimin e kryetares së Gjykatës Supreme, Besa Ademi, e cila kishte hedhur poshtë një nismë përluftimin abolidit apo faljes së ish-zyrtarëve, përfshirë edhe ish-kryeministrin Nikolla Gruevski që ishte miratuar në vitin 2016 nga presidenti atëherëshëm maqedonas, Gjorge Ivanov.

Ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, tha se gjyqësori mund të arrijë nivelet evropiane vetëm në rast se nisin bisedimet përligjshëm në union, por bisedimet janë bllokuar nga Bullgaria përluftak të mosmiratimit të ndryshimeve kushtetuese përligjshëm e pakicës bullgare në preambulën e saj, si popull shtetformues, ashtu siç

parashihet me një marrëveshje përligjshëm e kontesteve mes dy vendeve. "Unë konsideroj se ne nuk mund të arrijmë standarde në sundimin e ligjit pa nisjen e bisedimeve përligjshëm në BE. Ne mund të flasin përligjshëm standard ballkanik të sundimi të ligjit që mund ta arrijmë edhe vetë, por standartet evropiane nuk mund t'i arrijmë pa nisjen e bisedimeve përligjshëm. Janë dy procese të lidhura me njëra-tjetër. Bllokimi i rrugës tonë të anëtarësimit në BE është arsyja kryesore përligjshëm mosarritjen e këtij standardi evropian", deklaroi Osmani.

Ai tha se me ambasadorin e Holandës kanë pikëpamje të ndryshme sa i përket sundimit të ligjit. "Me ambasadorin e Holandës kemi dy dallime thelbësore në koncepte. Ai konsideron se ne mund të arrijmë standarde përligjshëm e ligjit edhe pa bisedime me Bashkimin Evropian. Dikush këtë e lexon si kompliment dhe dikush mund ta vlerësojë si qëllimkeq pasi Holanda është e njohur

përligjshëm e gatishmërisë përligjshëm e unionit", u shpreh Osmani. Por, nga ana tjetër, reagimi i ambasadorit të Holandës nxiti reagimin e opozitës shqiptare, sipas së cilës kritikat e këtij diplomati janë edhe një "dëshmi përligjshëm e kundërshtueshme". "Shihet qartë se tanë edhe partnerët ndërkombëtarë tashmë e kanë kuptuar mirëfilli se fjalët e BDI-së nuk përpunohen me veprimet e tyre dhe manipulimi i tyre është ai që i mban peng qytetarët e Maqedonisë së

Veriut që t'i jenë pjesë e familjes evropiane", ka deklaruar Izet Mexhiti, përfaqësues i Lidhjes Evropiane përligjshëm. Gjendja në gjyqësor ishte kritikuar edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian (KE), në veçanti përligjshëm e rezultateve në luftën kundërshtuese. Kritika përligjshëm nuk përfshinë kodin Penal që çuan në vjetësimin e shumë lëndëve gjyqësore ku ishin të përfshirë ish-zyrtarë të lartë shtetërorë.

/REL/



KRYEMINISTRI I IRLANDËS, LEO VARADKAR, KA QËNDRUAR TË MËRKURËN DHE TË ENJTN PËRVIZITË NË KOSOVË

Kryeministri i Irlandës: Asociacioni të themelohet, por jo të krijohet një mikro-shtet



Kryeministri i Irlandës, Leo Varadkar, pas takimit me homologun nga Kosova, Albin Kurti, ka thënë se ia ka bërë të qartë këtij të fundit se masat ndëshkuese ndaj Kosovës të vendosura nga Bashkimi Evropian duhet të hiqen, si dhe ka theksuar se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të themelohet, por nuk duhet të krijohet një mikro-shtet brenda Kosovës. Varadkar ka folur edhe për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka theksuar se nuk dëshiron të shohë më skena të dhunës në veri

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 JANAR - Kryeministri i Irlandës, Leo Varadkar, ka qëndruar të mërkurën dhe të enjten përvizitë në Kosovë. Ai është takuar me përfaqësuesit e institucioneve, me të cilët ka biseduar për bashkëpunimin mes dy shteteve si dhe ka dhënë mesazhe përinstitucionet e vendit sa i përket dialogut dhe procesit integruar të Kosovës.

Kryeministri Albin Kurti, pas takimit me Varadkar, në një konferencë përmes medie ka theksuar se është i lumtur dhe i nderuar të jetë sot nikoqir i kryeministrit Leo Varadkar, në vizitën e tij të parë në Kosovë.

Kurti ka thënë se Irlanda qëndron si një testament i forcës së unititetit, aleancës dhe angazhimit të qëndrueshëm përparrim. "Zhvillimi ekonomik dhe progresi social në dekadat e fundit e ka bërë Irlandën burim të frysëzimit për shumë shtete. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre përparrimeve i atribuohen edhe udhëheqjes së kryeministrit Varadkar, duke mishëruar një valë të re ndryshimesh pozitive.

Irlanda është veçanërisht frysëzuese për ne, sepse me të kemi ngashmëri që ne ndajmë. Nga pikëpamja shoqërore, populli

ynë shquhet për ngrohtësinë dhe mikpritjen e tij pavarësisht prej vështirësive që ka përfjetuar. Për sa iu përket aleancave ndërkombëtare, të dy shtetet gjëzojmë një aleancë të palëkundur dhe lidhje të ngushta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërkohë që të dy vendet tona janë të orientuara dhe të fokusuara kah rrjita thelbësore dhe progresi social", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se Irlanda është mbështetëse e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës. "Ne aplikuan gjatë presidencës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nga Irlanda, si dhe për anëtarësim në Bashkimin Evropian për çka kërkuan mbështetjen për statusin kandidat. Irlanda, po ashtu, ka dhënë kontribut të hershëm të cilin e vazhdon edhe sot në fushën e mbrojtjes përmes misionit të KFOR-it në Kosovë. Shteti dhe populli ynë janë gjithnjë falënderues e përgjithmonë mirënjojës. Andaj, takimi i sotëm ishte një rast shumë i mirë për të diskutuar mbi marrëdhëniet tona dypalëshe, përmundësitet që kemi para vetes për t'i thelluar ato, sa në rrafshin ekonomik e tregtar, po ashtu edhe në atë kulturor, politik dhe diplomatik", ka thënë Kurti.

Kryeministri i Irlandës, Leo Varadkar, pas takimit me homologun nga Kosova, Albin Kurti, ka thënë se ia ka bërë të qartë këtij të fundit se masat ndëshkuese ndaj Kosovës të vendosura nga Bashkimi Evropian duhet të hiqen, si dhe ka theksuar se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të themelohet, por nuk duhet të krijohet një mikro-shtet brenda Kosovës. Kjo nuk do të jetë e dobishme për të ardhmen", ka thënë ai në një konferencë përmes medie bashkë me kryeministrin Kurti. Varadkar ka theksuar se shteti i tij është një nga vendet e para që ka njojur pavarësinë e Kosovës në vitin 2008 dhe se është shumë krenar për kontributin e ushtarëve irlandezë që janë pjesë e KFOR-it në Kosovë. "Kurti dhe unë pajtohem që e ardhmja e Kosovës është në Bashkimin Evropian dhe në Këshillin e Evropës dhe do ta përkrahim Kosovën që të bëhet anëtarësimi i KE-së sivjet dhe të fillojmë edhe procesin e negociatave me Bashkimin Evropian për anëtarësim", ka potencuar kryeministri irlandez. Ai ka thënë se shpreson që ky të jetë viti kur Kosova do të bëhet anëtarë e Këshillit të Evropës. "Irlanda është një model për ta

ndjekur dhe mund të punojnë në këtë drejtim së bashku", shtoi ai. Varadkar ka folur edhe për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, derisa ka theksuar se nuk dëshiron të shohë më skena të dhunës në veri. "Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është jetik për të arritur një harmoni dhe për të pasur një zhvillim të dyjave vendeve. Sivjet duhet që ky stabilitet të konsolidohet. Nuk dua të shoh skena të dhunshme që i pamë gjatë muajit shtator", është shprehur ai.

Kryeministri i Irlandës ka pritur në takim edhe presidentja Vjosa Osmani.

Presidenca ka njoftuar se në takim u diskutua për zhvillimet aktuale politike dhe të fushës së sigurisë, interesat e përbashkëta dhe zgjerimin e mundësive përritjen e bashkëpunimit.

Me këtë rast u rikonfirmuan marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërmjet Kosovës dhe Irlandës, teksa presidentja Osmani falënderoi kryeministrin Varadkar përmeshtetjen e palëkundur në përpjekjet e vazhdueshme të Kosovës për paqe të qëndrueshme, stabilitet dhe zhvillim ekonomik.

Osmani shprehur mirënjojje përmeshtetjen e Irlandës në rrugëtimin e Kosovës drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës. "Anëtarësimi në Këshillin e Evropës është në dobi të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mundëson

mbrojtje të avancuar të të drejtave të njeriut", ka thënë presidentja Osmani.

Më tej, Osmani ka theksuar se është koha që edhe raportet e Kosovës me BE-në duhet të ngriten në nivel tjetër. "Kosova e meriton statusin e vendit kandidat. Kosova mishëron vlerat evropiane, ndaj në këtë frysë ka pasur angazhim të vazhdueshëm që legjislacioni ynë është në harmoni me ligjet e BE-së. Është momenti i duhur që ta marrim statusin e vendit kandidat", është shprehur presidentja Osmani.

Në raport me zhvillimet e fundit në vend, presidentja Osmani theksoi se Kosova tashmë ka bërë hapa përmbytjesorë për shpërshkallëzimin e situatës në veriun e vendit, ndaj i cilësoi masat e BE-së joproportionale dhe në dëm të qytetarëve të Kosovës. Në këtë kontekst, Osmani shprehur mirënjojje për qëndrimin e Irlandës kundër këtyre masave dhe përsëriti thirrjen për heqjen e tyre, nagaqë masat aktuale në fuqi kundër Kosovës janë të padrejta dhe krijojnë mungesë ekuilibri në dialog.

Kurse sa i përket situatës së sigurisë, Osmani tha se mungesa e masave kundrejt Serbisë në lidhje me sulmin terrorist dhe aktin e agresionit të 24 shtatorit në Banskë vetëm se inkurajon atë për të bërë sërisht veprime të ngashme, që cenojnë jo vetëm stabilitetin e Kosovës, por edhe rajonin.

Osmani dhe Varadkar theksuan rëndësinë e bashkëpunimit në adresimin e sfidave globale dhe nxitjen e zhvillimit në të gjitha sferat e interesit të përbashkët, me fokus të veçantë në fushën e arsimit dhe shëndetësisë.



INTERVISTË EKSCLUZIVE me Bardyl Mahmutin: Si u hoq cilësimi i UÇK-së si “organizatë terroriste”? (21)

Përfundimi i luftës në Kosovë dhe transformimi i LPK-së

Politologu Bardyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së njëzet e një, ka folur për përfundimin e luftës në Kosovë dhe transformimin e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Ai ka theksuar se më 26 qershor 1999 u votua për shndërrimin e LPK-së në parti politike. “Pas këtij vendimi, më 4 korrik 1999, u themelua Partia e Bashkimit Demokratik, ndërkaq më 7 korrik u formuan organet drejtuese të saj”, ka bërë me dije Bardyl Mahmuti, i cili ka dhënë edhe sqarime përkomunikatën e lëshuar nga qyteti Aarau i Zvicrës, në të cilën theksohej se LPK-ja nuk ka asgjë të përbashkët me Partinë e Bashkimit Demokratik. Gjithashtu, Bardyl Mahmuti ka folur edhe për reagimet kur dikush përmendte termin “marionetë” dhe “spion francez” për ish-udhëheqësin e Drejtorisë Politike të UÇK-së, Hashim Thaçin.

PRISHTINË, 11 JANAR-

“Epoka e re”: Pak përparrë përfundimit të luftës, organet drejtuese të LPK-së vendosën ta shndërronin pjesën e kësaj organizate që vepronte në Kosovë në parti politike. Edhe pse pati një proces të tërë rrëth kësaj çështjeje, transformimi i saj në parti politike nuk u përkrah nga të gjithë veprimtarët e saj. Ku ishin arsyet e divergjencave që sollën deri te refuzimi nga një numër veprimtarësh t'i pranonin rezultatet e Mbledhjes së Përgjithshme që u mbajt në Prizren në qershor të vitit 1999?

Bardyl Mahmuti: Duke qenë në rrjedha të zhvillimeve të bombardimeve të caqeve të forcave serbe dhe iniciativave diplomatike për t'i imponuar Slobodan Milosheviqit që t'i

pranonte kushtet e vëna për ndërprerjen e luftës, më 22 maj 1999, Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes Popullore të Kosovës vendosi t'i kërkojë mendimet e strukturave të saj (nënëgëve,

këshillave të rrtheve dhe këshillave popullore) lidhur me një varg çështjes, në mesin e të cilave edhe mendimin për transformimin e kësaj organizate në parti politike.

Në përputhje me përgjigjet që morën nga strukturat e organizatës u formua grupi i punës që do ta përgatiste Mbledhjen V të Përgjithshme brenda vendit në përbërje të të cilit ishin Ali Ahmeti, Ibrahim Kelmendi, Ramadan Avdiu, Halil Selimi, Xhevati Bislimi, Mehmet Bislimi dhe Ramiz Lladrovci, ndërkaq Bedri Islami, Hasan Ukëhaxhaj dhe unë u ngarkuam ta koordinonim veprimtarinë me Qeverinë e Përkohshme. Pas takimeve konsultative me veprimtarët e LPK-së në Kosovë dhe mbledhjeve konsultative në Prishtinë dhe Prizren, më 26 qershor u mbajt Mbledhja V e Përgjithshme e LPK-së në Prizren. Me 1 votë kundër dhe 4 abstenime, delegatët që ishin të

pranishëm votuan për shndërrimin e LPK-së në parti politike. Pas këtij vendimi, më 4 korrik 1999, u themelua Partia e Bashkimit Demokratik, ndërkaq më 7 korrik u formuan organet drejtuese të saj.

“Epoka e re”: Në mbledhjen themeluese të partisë ju u zgjodhët kryetar partie, z. Jakup Krasniqi nën kryetar, ndërkaq z. Shaban Shala sekretar i përgjithshëm. Çfarë ndodhi me kryetarin e deri atëherës në LPK-së, z. Bedri Islami?

Bardyl Mahmuti: Në momentet më të rëndësishme të luftës çlirimtare, Bedri Islami ka qenë kryetar i organizatës dhe, falë urtësisë së tij, gjérat kanë shkuar ashtu si duhej. Është e habitshme energjitet intelektuale dhe fizike që ka poseduari ky njeri në atë kohë. Përveç takimeve të rëndësishme për rrjedhat e luftës, ai ka shkruar disa qindra artikuj dhe fjalime për ta arsyetuar domosdoshmërinë e luftës çlirimtare dhe për t'i mobilizuar mërgimtarët ta përkrahnin këtë luftë. Për arsyet e personale ai vendosi të mos jetë kandidat për udhëheqës partie. Nëse do ta shprehte dëshirën ta vazhdonte udhëheqjen e strukturës sonë, jam i bindur se do ta fitonte besimin e shumicës. Unë do të votojo për të!

2. Është hedhur mendimi për shndërrimin e LPK ne një parti politike shqiptare, që mbrojnë devjësish interesat kombëtare. Ky mendim nuk ka lindur vetëm në rradhët e organizatës, por edhe në qarqe të tjera, me të cilat ka bashkëpunuar organizata jone. Shndërrimi i saj në pari politike, me rishikimin e programit pa hequr dorë nga përcaktimet kombëtare të tij, me rishikimin e statutit, duke u mbështetur në atë ekzistues, me përcaktimet të qarta përvaresinë e kosovës dhe bashkimin kombëtar si çështje e shtruar për zgjidhje do t'j bëjë që në skenën politike të kosovës të ketë një parti rrëth së cilës mund e duhet të mblidhen njerezit e përkushtuar ndah çështjes kombëtare.

"Epoka e re": Një javë më vonë, më 11 korrik 1999, në emër të Kryesisë së Nënëdegsës së LPK-së për Zvicër, u lëshua një komunikatë nga qyteti Aarau i Zvicrës, nëpërmjet së cilës deklarohej se LPK-ja nuk ka asgjë të përbashkët me Partinë e Bashkimit Demokratik dhe se kjo organizatë do ta vazhdojë veprimtarinë për arritjen e misioneve të veta. Si e keni parë këtë komunikatë në atë kohë?

Bardhyll Mahmuti: Edhe pse kam qenë në dijeni se prapa shkrimit të asaj komunikate nuk ka qëndruar kryesia e Nënëdegsë së LPK-së për Zvicër dhe as nënshkrimi i sekretarit të saj (sepse Xhevati Kabashi ka qenë në Kosovë, së bashku me Ramadan Avdiu, Murat Bytyqin dhe Muharem Elshanin), ne nuk kemi reaguar.

Ka qenë plotësisht e mundshme që ndonjëri prej tyre të ketë qenë kundër transformimit të LPK-së në parti politike, madje Muharem Elshani ka qenë i vërtmi delegat në Mbledhjen V të Përgjithshme që ka votuar kundër. Mirëpo ishim të bindur se cilësimi që u bëhej "disa anëtarëve të Degës së LPK-së si karrieristë të sëmurë të cilët mendojnë se edhe LPK-në e kanë lodër për sëmundjet e tyre karrieriste" nuk mund të vinte nga Murat Bytyqi, Ramadan Avdiu apo Xhevati Kabashi.

procesin e transformimit të LPK-së në parti dhe garuan për pushtet në Kosovë. Aju ka shkuar ndër mend t'i akuzoni se kanë bërë "puç" kundër Mbledhjes V të Përgjithshme që u mbajt në Prizren?

Bardhyll Mahmuti: Komplotet karakterizohen me aksione të fshehta të kryera nga individë apo grupe me qëllim që të bëjnë dëm, dhe gjatë historisë ka pasur komplotet që hulumtimet kanë nxjerrë në pah detajet se si janë organizuar dhe kryer ato. Mirëpo, në politologji teorja që përpinqet t'i shpjegojë rrjedhat shoqërore nëpërmjet komplotit konsiderohet si një çati ku përpinqen të strehohen ata që nuk kanë mjete të tjera teorike për t'i shpjeguar gjérat. Unë jam politolog dhe në asnjë rast nuk mendoj se ata që kanë vazhduar LPK-në kanë pasur qëllim të keq. Është çështje tjetër se sa kanë ditur t'i realizojnë misionet për të cilat janë përcaktuar. As nuk i kam kritikuar dhe as i kam quajtur "karrieristë të sëmurë" kur kanë garuar në zgjedhje në emër të LPK-së, as kur janë transformuar në Parti Socialiste, as kur e kanë zhbërrë Partinë Socialiste pas dështimit në zgjedhje. Nëse Partia e Bashkimit Demokratik "nuk ka pasur asgjë të përbashkët me Lëvizjen Popullore të Kosovës", siç deklaroheshin nëpërmjet komunikatës së lartpërmendur,

asnijë vërejtje të vetme rreth angazhimeve të tyre në këto dy luftëra! Përkundrazi kanë vetëm mburje!

Ata harrojnë gjënë thelbësore në angazhimet politike: rezultatin final! Nëse ne "puçistët" bëmë "komplot" kundër tyre për ta marrë në duar udhëheqjen politike të luftës çlirimtare në Kosovë, ndërsa ata kishin "duart e lira" të udhëhiqin luftën në Luginë të Preshevës dhe në Maqedoni, do të ishte mirë t'i shihnin rezultatet!

Kur shoh gjendjen e shqiptarëve në Luginë të Preshevës, si popull më i shqypur dhe më i diskriminuar në Evropë, dhe kur shoh që të drejtat e shqiptarëve autohtonë në trojet e veta nën Maqedoni përcaktohen me përqindjet e manipuluara, atëherë nuk më vjen keq të deklaroj publikisht se shqyr që nuk kanë fituar besimin e delegatëve të Mbledhjes VI të Përgjithshme të LPK-së Dega Jashtë Vendit, sepse ka pasur rezik që rrjedhat të merrnin drejtime të padëshiruara.

Në vend që të vazhdojnë me akuza kundër "puçistëve" që i larguan nga drejtimi i organizatës në maj të vitit 1998, do të ishte mirë të jepnim sqarime për veprimtarët e devotshëm nëse shuarja e "LPK-së së tyre" nënkupton se kanë realizuar misionet politike të Lëvizjes



përmasave të gjera nga ata që shihnin gjithkund "komplot" dhe kaloi caqet e divergjencave individuale. Prandaj nuk po ua përmend emrat. Por, siç thotë një shprehje populllore, "kush është Bektesh e merr vesh"!

Në këtë kontekst e pashtë të udhës të sqaroj për opinionin publik shqiptar se prapa emrit "Pierre Sirami" nuk qëndron asnjë shef i Shërbimit Francez, por bëhet fjalë për pseudonimin e Maurice Dufresse, një ish-zëvendësdrjetor teknik, i pensionuar për "çështje shëndetësore" dhe i cili ka botuar një libër, ndaj të cilit janë ngritur disa padi për shpifjet! E pashtë të udhës të sqaroja se në librin e tij autorit "Dëshmia e Pierre Siramy-t, 25 vjet në shërbimet sektore", në 793 faqe të shpërndarë falas përmes internetit, nuk e gjen as dhe një fjalë të vetme për Hashim Thaçin! Sipas mendimit tim, është e turpshme kur, për inate personale, bashkëveprimtarët e dikurshëm përhapin shpifje të tillë!

"Epoka e re": Megjithatë akuzat për "marioneta të shërbimeve sekrete" nuk kanë pushuar as sot e kësaj dite!

Bardhyll Mahmuti: Pavarësisht prej dëshirës së atyre që synojnë të krijojnë huti, njerëzit nxjerrin konkluzione në bazë të rezultateve. Nëse "marionetat e shërbimeve sekrete" arritën ta drejtojnë politikisht luftën dhe ta çlirojnë Kosovën, ndërkaq përpjekjet e "anëtarëve të devotshëm të LPK-së anembanë globit" nuk arritën t'i çlironin territoret shqiptare të Luginës së Preshevës dhe në Maqedoni, atëherë diçka nuk është në rregull me koherencën e tyre!

"Epoka e re": Për aq sa kemi dijeni, LPK-ja vazhdon ekzistencën e saj.

Bardhyll Mahmuti: Nëse përdorim gjuhën e komunikatës që është përdorur kundër Partisë së Bashkimit Demokratik, atëherë mund të themi se shpërbërja e Partisë Socialiste të Kosovës që pretendonte se ishte vazhdimesi e LPK-së u bë nga ata që këtë organizatë e kanë konsideruar me logjikën e "lodrës". Mirëpo ka veprimtarë që nuk janë pajtuar me këtë rrjedhë të ngjarjeve. Edhe sot e kësaj dite Murat Bytyqi përpinqet ta mbajë gjallë organizatën me emrin LPK. Murat Bytyqi është një veprimtar i shquar i çështjes kombëtare, me të cilin kemi qenë në burgun e

Pozhavracit dhe ndaj të cilit ruaj respektin që e kam pasur gjithmonë.

"Epoka e re": A e dini se çfarë bëjnë konkretisht veprimtarët që kanë vazhduar veprimtarinë në kuadër të LPK-së?

Bardhyll Mahmuti: Aspiratat që ishin shtruar në platformën politike të Lëvizjes Populllore të Kosovës nuk janë realizuar tërësisht as sot e kësaj dite. Me kapacitetet që kanë, ata përpinqen të mbajnë gjallë këtë frysë. Po ju jap një shembull konkret. Pas agresionit serb në Banjskë, Murat Bytyqi organizoi një takim me veprimtarët të dalluar të çështjes kombëtare me qëllim që t'i ndanin shqetësimet me situatën e krijuar dhe të bashkërenditesh të bashkërenditesh të veprimtaritë në interes të Kosovës. Isha i ftuar edhe unë. Për shkak të gripit që më kishte rënë nuk munda të shkoj, përndryshe do të merrja pjesë.

"Epoka e re": Disa muaj pas themelimit të Partisë për Bashkim Demokratik ju u bashkuat me pjesën tjetër të Drejtorisë Politike për ta themeluar Partinë për Prosperitet Demokratik të Kosovës, e cila në Kuvendin e Parë Zgjedhor mori emrin Partia Demokratike e Kosovës.

Bardhyll Mahmuti: Deshëm apo nuk deshëm, qëndrimi i disa anëtarëve të LPK-së ta vazhdonin realizimin e misionit të kësaj organizate me të njëtin akronim na vinte në pozitë që të arsyetonim vazhdimesi legjitimitetin e lindjes së Partisë për Bashkim Demokratik. Në këtë kontekst, një numër drejtuesish të partisë ishin të mendimit se duhej të bashkoheshin rreth një partie politike të gjitha forcat dhe veprimtarët që kishin mbështetur luftën çlirimtare. Fryma e bashkimit dominante gjithkund në radhët tona dhe, si rezultat i kësaj fryme, më 12 tetor 1999, së bashku me Hashim Thaçin, nënshkruam deklaratën e bashkimit politik për t'i dhënë fuqi një force të përbashkët politike.

Është e habitshme se pikërisht ata që nuk njihin "legjitimitetin e transformimit të LPK-së në Partinë për Bashkim Demokratik", vazhdojnë të shkruajnë në shkaravat e tyre se gjoja u bë puç kundër meje për "me ma marrë partinë"! Janë pikërisht njerëz që partitë i shohin si "lodra" në duar të dikujt!

(Muhamet MAVRAJ / Vizioni)

"Njëanimisht nuk kanë qenë të informuar mbi rrjedhën e punës organizative të LPK-së, se Lëvizja Popullore e Kosovës nuk ka asgjë të përbashkët me Partinë e Bashkimit Demokratik. Disa nga anëtarët e Degës së LPK-së të cilët janë bëre cilët mendojnë se edhe LPK-në e kanë lodër për sëmundjet e tyre karrieriste. Për veprimet e tyre të qëllimta në drejtim të shuarjes së Lëvizjes Popullore të Kosovës.

Lëvizja Popullore - K.

"Epoka e re": A e dini se kush e ka shkruar këtë komunikatë?

Bardhyll Mahmuti: Po! E dimë edhe kush e ka shkruar edhe kush e ka shpërndarë nga Cyriku. Nuk e shoh të udhës t'ua përmend emrat. Ai që e ka shpërndarë komunikatën nga Cyriku ka qenë një atdhetar i madh dhe veprimtar i shquar për çlirimin e vendit dhe pa marrë parasysh që nuk është pajtuar me proceset që janë zhvilluar në atë kohë, unë ruaj respektin për të!

"Epoka e re": Pse nuk reaguat?

Bardhyll Mahmuti: Nuk e kemi parë të udhës ta mohojmë të drejtën e atyre që mendonin se duhet ta ruamin vazhdimesinë e LPK-së për t'i realizuar misionet në territorët e pushtuara nga Serbia në Luginë të Preshevës, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Asnjëherë nuk i kam dhënë vetes të drejtë t'i mohoj dikujt të drejtën të veprojë edhe në emër të asaj organizatës, pjesë e së cilës kam qenë.

"Epoka e re": Ata që ju akuzonin se i keni larguar nga udhëheqja e organizatës nëpërmjet "puçit" që keni bërë në Mbledhjen VI të Përgjithshme të LPK-së Dega Jashtë Vendit, nuk njohën

atëherë mund të them me plotë të drejtë se ata që nxorën në "tregun elektoral" akronimin që qëndron në themelit e lirisë së Kosovës dhe që dështuan në mënyrën më të keqe të mundshme, nuk mund të pretendojnë se kanë diçka të përbashkët me frysë e Lëvizjes Popullore të Kosovës. Madje dështimin e tyre personal në zgjedhje nuk mund t'ia atribuojnë LPK-së!

"Epoka e re": Zhvillimet e asaj kohe i shpjegoni si rezultat i luftës politike brenda LPK-së. Megjithatë ju ka ndodhur të reagoni ashpër kur dikush ka përmendor termin "marionetë" dhe "spion francez" për ish-udhëheqësin e Drejtorisë Politike të UÇK-së, z. Hashim Thaçi.

Bardhyll Mahmuti: Në atë kohë Hashim Thaçi ishte në funksione publike me përgjegjësi të lartë shtetërore në Prishtinë dhe kishte mundur të mbrohej vetë ndaj çfarëdo akuzash, pa pasur nevojë për "mbrojtjen time"! Mirëpo ai që ngriti akuza të tilla dhe disa ish-bashkëveprimtarë më janë drejtuar publikisht nëpërmjet "Facebook"-ut që të jap mendimin tim lidhur me këto pretendime. Shpifjet ndaj Hashim Thaçit si "spion i Francës...", të mbështetura në thëniet e gjoja "ish-shefit të shërbimit francez Pierre Siramy", u shndërruan në një histeri të

Vitin e kaluar 2 000 persona përfituan subvencione nga kryeqyteti për trajtimin e sëmundjeve të rënda

PRISHTINË, 11 JANAR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se më shumë se 2 000 persona vitin e kaluar kanë përfituar subvencion nga kryeqyteti për trajtimin e sëmundjeve të rënda. Sipas tij, i bie rritje prej 20-përqindësh më shumë në krahasim me vitin 2022. "Sot

punëtorët e zellshëm të Sektorit të Shërbimit me Qytetarë janë mbingarkuar nga kërkesat e qytetarëve për subvencionimin nga Drejtoria e Shëndetësisë për sëmundjet malinje dhe kronike të rënda. Në lidhje me këtë, ju njoftoj se kërkesat e juaja pranohen gjatë gjithë viti dhe ato do t'i shqyrtojë komisioni

profesional. Ne jemi të vetëdijshëm se jetesa me një sëmundje kronike sjell sfida të mëdha, jo vetëm shëndetësore, por edhe financiare. Qëllimi ynë është të sigurojmë që të mos ndiheni të vëtmuar në këtë luftë dhe të ofrojmë një dorë ndihme aty ku është më e nevojshme", ka theksuar Rama.



90 për qind e pacientëve të trajtuar në Klinikën e Endokrinologjisë kanë qenë me diabet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 JANAR - Sëmundja e sheqerit, apo diabetit melit, është një nga sëmundjet kronike metabolike, e cila, për shkak të rritjes së sheqerit në gjak për një kohë të gjatë, mund të shkaktojë komplikime serioze, të cilat, po nuk u mjekuan me kohë, mund ta rezikojnë shëndetit e pacientit. Drejtoresha e Klinikës së Endokrinologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, dr. Merita Emini-Sadiku, ka theksuar se 90 për qind e pacientëve të trajtuar në këtë klinikë kanë qenë me diabet. "Trajtimi i diabetit melit është sëmundje që me të drejtë quhet multisistemike sepse prek inde dhe organë të ndryshme në trup dhe ka nevojë jo vetëm për endokrinologun dhe mjekun familjar, por edhe për shumë specialitete të tjera mjekësore, varësish se çfarë komplikimi ka pacienti", ka potencuar Emini-Sadiku.

Sipas endokrinologes, shumica e komplikimeve dhe rreziqueve te diabeti vijnë si rezultat i kujdesit jo të mirë, por dhe vonesës në kërkimin e ndihmës së mjekut. Ajo këshillon që për menaxhim të diabetit melit nevojitet bashkëpunim i ngushtë dhe korrekt ndërmjet pacientit dhe mjekut në zbatim të këshillave mjekësore, marrjes së terapisë së rregullt dhe kujdesit individual të përditshëm nga pacienti.



Këshillat mjekësore

Vizito mjekun kompetent, vlerëso rrezikun e komplikimeve; Të jesh me diabet, nuk do të thotë të kesh edhe komplikime në organë sic janë sytë, zemra, veshakët, truri dhe ulcerat në këmbë; Ulcerat në këmbë dhe problemet me zemër janë më të shpeshta te kontrolli jo i mirë i sheqerit dhe kur për një kohë të gjatë sheqeri në gjak, apo glikemia është e lartë; Mbajini vlerat e glikemisë nën 7, mmol/L dhe merrni këshillat e nevojshme nga mjeku juaj sidomos

informohuni sa shpesh duhet matur glikeminë dhe kur duhet të bëni vizitat mjekësore; Diabetin për ta trajtuar mirë duhet bashkëpunim i ngushtë mes pacientit dhe mjekut.

Rreziku dhe llojet e komplikimeve

Komplikimet kronike mikrovaskluare me dëmtime në sy nga diabeti, apo retinopati diabetike janë 39.5 për qind; Dëmtimet e nervave të gjymtyrëve, apo neuropati diabetike distale 53 për qind; Dëmtimet në veshka apo

nephropati diabetike 24.7 për qind; Komplikimet kronike makrovaskluare me sëmundje kardiovaskulare (përfshire këtu koronaropati, hipertension dhe sëmundje kardiovaskulare tjera) 60.12 për qind e pacientëve me diabet tip 2, me sëmundje cerebrovaskulare 4.5 për qind dhe me këmbë diabetike 7.7 për qind.

Trajtimi dhe ofrimi i shërbimeve

Klinika e Endokrinologjisë posedon të gjitha shërbimet e nevojshme sa i përket

sëmundjes së sheqerit; Ofron edukim për sëmundjen, përcaktimin e dietës specifike individuale, koordinimin e terapisë, të bazuar në protokolle të përditësuara (insulinoterapi, ose barna tjera); Ofron shërbimin për këmbë diabetike, vlerësimin e komplikimeve kronike dhe rrezikun për komplikime akute dhe shërbimin gjysmë intensiv për raste të rënda të kësaj sëmundje; Ofron shërbime ambulantore specialistike çdo ditë pune, punojnë 4 deri në 6 endokrinologë, në orare të ndryshme.

Maqedonci: Mazanek shprehu gatishmërinë për ta akredituar atasheun e Mbrojtjes së Kosovës në Çeki

PRISHTINË, 11 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur të enjten në takim njoftues ambasadoren e Republikës së Çekisë në Kosovë, Bohumil Mazanek, të cilit i ka uruar mirëseardhje dhe e ka falënderuar përmështetjen e Republikës së Çekisë nëpër të gjitha proceset e shtetndërtimit si dhe kontributin e dhënë në kuadër të misionit të NATO-s.

Në takim u bisedua lidhur me situatën momentale të

sigurisë në vend dhe përkrahjen e shtetit të Çekisë në rrugën drejt Partneritetit për Paqe dhe iniciativave të tjera, ku ministri Maqedonci theksoi se kjo është e vëmja mënyrë që garanton paqen dhe sigurinë në Kosovë dhe rajon. Gjithashtu u bisedua përritjen e mëtejme të bashkëpunimit në mes të dy vendeve, me theks të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjes përbashkëpunit të mes të

ministrive të Mbrojtjes të të dyja vendeve.

Nga ana e tij, ambasadori çek Mazanek shprehu kënaqësinë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe theksoi se vendi i tij do të vazhdojë fuqishëm ta mbështesë Republikën e Kosovës në rrugën drejt integrimit euroatlantik. Ndër të tjera, ambasadori Mazanek shprehu gatishmërinë e Republikës Çeke për ta akredituar atasheun e Mbrojtjes së Kosovës në Çeki.



Mos vajtoni për ata që po ikin, por pyesni veten çfarë po bëni që ata që janë në Kosovë të mbeten në Kosovë



Shkruan:
Safet GËRXHALIU

Viti i ri 2024 filloi me një lajm të pritur, lajm pozitiv, por të vonuar për liberalizimin e vizave. Kjo ka qenë një endërr e kamotshme që në Kosovë vërtetë ka ndikuar në forma të ndryshme. Ka qenë një

mungesë e liberalizimit që ka goditur ekonominë e Kosovës, ndërkaq në aspektin politik ka dëmtuar imazhin e Kosovës por në aspektin psikologjik dhe emocional ka qenë vërtetë një momentum ku shqiptarët apo kosovarët e kanë ndjerë veten të përjashtuar padrejtësisht. Ajo çfarë është duke dominuar kohëve të fundit, po shohim debatin rreth largimit të qytetarëve të Kosovës nga Kosova. Duhet të kuptohet që nga Kosova nuk tentojnë apo pretendojnë të largohen vetëm të papunët dhe skamnorët, janë duke ikur edhe familje që kanë një stabilitet ekonomik dhe në këtë drejtim kjo duhet të

jetë një brengë për institucionet që të bëjnë më tepër për t'i motivuar të rinjtë për të qëndruar në Kosovë dhe jo për t'i numëruar sa ikin nga Kosova. Janë shumë arsyesh për institucionet dhe sektorin privat është që të mos vajtojnë për ata që po ikin por të bëjnë më tepër që ata që janë në Kosovë të mbeten në Kosovë. Kam pritur që këto ditë qeveria apo kryeministri do të del me një konferencë për medie për të paralajmëruar fillimin e zbatimit të ligjit për sigurinë shëndetësore, kam pritur që do të ketë një pako për të motivuar të rinjtë dhe bizneset, për të rritur pagat dhe për të krijuar stabilitet social.

Kam menduar që do të ketë kampanja vetëdijesuese se Evropa nuk është ajo e viteve të '90-ta por është në masa të inflacionit dhe në një presion politik shkaku i ndodhive globale. Prandaj, definitivisht është obligim moral që të punohet në këtë drejtim. E drejta për të lëvizur është humane dhe njerëzore, e drejta për të gjetur për të jetuar aty ku është më mirë dhe ku e ndjen veten po ashtu është e drejtë humane, dhe në këtë drejtim duhet të krijohen kushtet për të jetuar në Kosovë, për të mos e zbruzur Kosovën dhe jo për të vajtar sesa e si po ikin nga Kosova.

Emiratet e Bashkuara Arabe heqin vizat për qytetarët e Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe, Mohammed bin Zayed al-Nahyan, ka pranuar propozimin e saj për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës. Përmes një shkrimi në platformën "X", Osmani ka thënë se marrëveshja ishte arritur gjatë takimit dydalësh në muajin e kaluar dhe "tashmë është nënshkruar, duke hapur rrugë për më shumë mundësi bashkëpunimi midis vendeve tona dhe qytetarëve tanë". Prej 1 janarit shtetasit e Kosovës me pasaporta biometrike janë në gjendje të udhëtojnë lirshëm



në shtetet e Zonës Shengen, pas hyrjes në fuqi të vendimit për liberalizimin e vizave.

Ndërsa më 5 janar u bë e qartë se ata do të mund ta vizitojnë edhe Spanjën, pas një njoftimi

nga Departamenti për Migrim dhe Çështje të Brendshme i Komisionit Evropian, se Spanja njeh tashmë pasaportën e zakonshme të Kosovës.

Liberalizimi i vizave u mundëson qytetarëve të Kosovës, që kanë pasaporta biometrike, të qëndrojnë deri në 90 ditë brenda gjashtë muajsh në cilindro nga 27 shtetet anëtare të Zonës Shengen.

Udhëtimet pa viza shërbejnë për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme. Megjithatë, liberalizimi i vizave nuk nënkupton leje pune apo përfitime të tjera.

Kosova ishte vendi i fundit i Ballkanit Perëndimor, qytetarët e të cilit deri më 1 janar të këtij viti nuk mund të lëviznin

lirshëm në Zonën Shengen. Ish-ambasadori i Kosovës në Emiratet e Bashkuara Arabe, Avni Arifi, ka reaguar pas heqjes së vizave nga Emiratet e Bashkuara Arabe. "Lajmi për heqjen e vizave nga ana e Emirateve është lajm shumë i mirë për Kosovën. Emiratet e Bashkuara Arabe nuk janë vetëm vend i rëndësishëm politik në Lindjen e Mesme apo destinacion turistik global por mbi të gjitha është vendi i pestë në botën e rieksperteve globale (trade hub) dhe ofron potencial të jashtëzakonshëm ekonomik për bashkëpunim jo vetëm me kompanitë e këtij vendi por me të gjitha kompanitë botërore. Kjo është një lehtësim jo i vogël për kompanitë e Kosovës", ka shkruar Arifi në "Facebook".

KEDS-i ndërtoi nënstacionin e ri në Kaçanik, përfitues mbi 12 mijë qytetarë dhe biznese

PRISHTINË, 11 JANAR - Në daljen e parafundit të autostradës Prishtinë - Shkup, përkatësisht në Doganaj të Kaçanikut, kur merr drejtimin për Brezovicë, shtrihet një objekt krejtësisht i ri, i veshur me një fasadë që rrezaton bardhësi në këtë dimër pa borë. Është ky nënstacioni Kaçaniku II 35/10 kV prej të cilit përfitojnë mbi 12 mijë qytetarë dhe biznese të asaj ane. Me lokacion vetëm disa metra nga fabrika e Silcaporit, një nga më të mëdhatë në vend, ky nënstacion jep një mesazh të qartë: Kosova po zhvillohet. KEDS-i investoi fuqishëm aty në përgjigje të kërkesës në rritje përfundim me energji elektrike të pjesës juglindore të vendit.

Ky nënstacion është realizuar me qëllim të përmirësimit të qëndrueshmërisë në furnizim, zvogëlimit ose eliminimit të mbingarkesave në rrjet, përmirësimit të rënieve të tensionit dhe mbështetjes ndaj rritjes së ngarkesës.

Që nga data 26 dhjetor 2023 nga daljet e këtij nënstacioni, Doganaj, Duraj, Kaçaniku i Vjetër dhe Dubravë - Kaçanik furnizohen më shumë se 3 500 konsumatorë. Nënstacioni i ri është duke përmirësuar ndjeshëm stabilitetin e rrjetit energjetik në Kaçanik. Duke rishpërndarë ngarkesën dhe duke optimizuar rrjetdhënë e fuqisë, janë eliminuar edhe mbingarkesat dhe rëniet e tensionit.

Nënstacioni i ri është projektuar duke lejuar zgjerimet e ardhshme dhe duke përshtatur kërkesat në rritje për energji të rajonit të Kaçanikut. Projekti është realizuar brenda një periudhe shumë të shkurtër falë angazhimit maksimal të ekipeve tona dhe vendosmërisë së kompanisë që ky nënstacion të jetësitet sa më parë. Investimet e tillë kapitale, si ky në Kaçanik, ndikojnë në përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës energetike duke rezultuar me rritje të



besueshmërisë së sistemit dhe furnizim të qëndrueshmë. "Përfundimi me sukses i projektit të nënstacionit të tensionit të mesëm në Kaçanik është një dëshmi e përkushtimit të kompanisë sonë për t'i përbushur nevojat në zhvillim të konsumatorëve tanë. Duke adresuar sfida të tillë si stabiliteti i rrjetit dhe rrjetja e ngarkesës, ne kemi përmirësuar ndjeshëm besueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të shpërndarjes së energjisë. Ky projekt është një nga 400 projektit investive që kompania filloi implementimin anekënd vendit duke ndikuar që rrjeti i shpërndarjes të kalojë në një nivel më të avancuar", ka njoftuar KEDS-i.

Çfarë dihet për rastin e faturave fiktive në ATK?

PRISHTINË, 11 JANAR -

Dymbëdhjetë zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) janë arrestuar më 9 janar gjatë një aksioni të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe hetuesve të Drejtorisë së Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës. Ata dyshohen përmashtrim në detyrë.

Prokurori i Shtetit ka bërë me dije të martën se ndaj zyrtarëve është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh. Ata dyshohet se janë përfshirë në një rast me tre pronarë biznesesh, të cilët, duke përdorur dokumente të rrejshme dhe shmanjë nga tatimi, ishin gati ta dëmtonin buxhetin e shtetit të Kosovës në vlerë prej 2.8 milionë eurosh. Një prej këtyre personave është arrestuar të martën, ndërsa dy të tjerë janë në kërkim.

Prokuroria ka bërë kërkesë pasditen e së mëkurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë për caktimin e masës së paraburgimit për 13 të arrestuarit, konfirmoi për Radion Evropa e Lirë zëdhënësja e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, Laureta Ulaj. Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka reaguar lidhur me këtë rast dhe zëdhënësja Valentina Bytyçi i ka thënë Radios Evropa e Lirë se kjo është për arsy se ende, sipas saj, nuk kanë pranuar nga Prokuroria asnjë shkresë me emrat e zyrtarëve të dyshuar.

Si erdhi deri tek arrestimi i tyre?

Prokuroria tha se të pandehurit kishin pranuar në institucionin e ATK-së 23 fatura fiktive nga një pronar biznesesh në Prizren, i identifikuar me iniciale F. P.

Ky i fundit, sipas Prokurorisë, kishte aplikuar përmbrësim nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) me fatura fiktive që arrin në vlerën prej 18 milionë eurosh.

Rimbursimi pastaj do të bëhej në vlerë prej 2.8 milionë eurosh. Policia arrestoi të martën edhe të dyshuarin F. P., pronar i tri



bizneseve në Prizren.

Të mëkurën Radio Evropa e Lirë bisedoi me Valdrin Gashin, avokat i cili po e mbrojnë të pandehurin, dhe ai konfirmoi se bëhet fjälë për Feim Pulajn, pronar i hotelit "Lakeside" në Vërmicë të Prizrenit. Gashi konfirmoi se të martën janë kryer bastisje në shtëpinë e Pulajt, veturën dhe hotelin e tij.

Në mbrëmje vonë, tha ai, është dhënë deklarata në Policiinë e Kosovës, ndërsa tanë janë në pritje të një njoftimi nëse do të caktohet seanca për paraqitje në gjykatë.

Sipas prokurorisë, zyrtarët tatimore ia kishin njohur si të rregullta faturat Feim Pulajt, "kinse përndërtimin e një hoteli, i cili veçse ka qenë i ndërtuar më parë".

Aksioni i autoriteteve të Kosovës është zhvilluar në Prizren dhe Podujevë dhe, sipas njoftimit zyrtar të Prokurorisë, të arrestuarit dyshohen për kryerjen e tri veprave penale: "Mashtrimi në detyrë", "Dokumente të rrejshme lidhur me tatimin" dhe "Shmanjë nga tatimi".

Ku i kishte siguruar pronari i hotelit faturat fiktive?

Prokuroria tha se dy persona të tjerë, B. B. dhe B. B., pronarë të një biznesi në Podujevë, kanë vënë në dispozicion faturat për F. P., biznesmenin nga Prizreni që avokati i tij e identifikoi si Feim Pulaj.

Autoritetet e rendit vazhdojnë t'i kërkojnë edhe dy personat të cilët dyshohet se bashkë kanë kryer veprat penale "Dokumente të rrejshme lidhur me tatimin" dhe "Shmanjë nga tatimi". Si rezultat i këtyre veprimeve, zyrtarët e ATK-së i kanë njohur të drejtën e rimbursimit të TVSh-së së zbritshme në shumën prej 2.8 milionë eurosh. Pavarësisht se faturat e paraqitura ishin fiktive, aplikimi i pronarit të biznesit përmbrësim për TVSh ishte pranuar. Por, Prokuroria tha se procedura është pezulluar në momentet e fundit për shkak të inicimit të rastit penal ndaj të

pandehurve.

Zyrtarët tatimore përfshirë në këtë rast, sipas Prokurorisë, janë: M. Z., N. B., S. T., A. J., M. R., M. Z., M. B., G. Gj., A. P., V. K., A. R., Xh. H.

Çfarë u konfiskua gjatë aksionit?

Armë e pajisje të tjera u gjetën dhe u konfiskuan gjatë aksionit të 9 janarit.

Batisjet kryesore u kryen në dy lokacione, në Prishtinë dhe në Prizren.

Gjatë kontrolleve në objektet e personit me iniciale F. M., sipas Prokurorisë, u gjetën dhe u konfiskuan armë, prej tyre tri të gjata dhe tri të shkurtë. Po ashtu, u konfiskuan pajisje elektronike, telefona dhe prova të tjera materiale.

Dënimet sipas Kodit Penal të Kosovës

"Mashtrimi në detyrë" është vepër penale e dënueshme sipas Kodit Penal të Kosovës, e

përcaktuar me nenin 419. Gjebë dhe dënim me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet parashihet në rastet kur me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, dikush bën krijimin, përdorimin ose prezantimin e rremë të raportit të llogarive "apo në ndonjë mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar, për kryerjen kundërligjshëm të pagesës ose transferit të parave, pasurisë ose të drejtave tjera".

Ndërsa dënim me deri në tetë vjet burgim shqiptohet kur vepra penale është në vlerë pasurore mbi 5 000 euro, derisa për shumën mbi 50 000 euro parashihet burgim deri në dymbëdhjetë vjet.

Pika tjetër e këtij nenit parashoh dënim me gjebë ose burgim prej një deri në tetë vjet për personin që me qëllim të kryerjet, fshehjet ose maskimit të një vepre penale, "krijon ose përdor një faturë ose ndonjë dokument tjetër kontabël ose regjistrim që përbën informata të rrejshme ose jo të plota, ose heq dorë nga regjistrimi i pagesës".

Dënim me gjebë dhe me burgim nga tre deri në tetë vjet parashihen edhe për personat që përdorin dokumente të rrejshme lidhur me tatimin.

Përdorimi i faturave fiktive dënohet me deri tre vjet burgim e "nëse vepra penale është kryer për të shmanjur pagesën e tatimit prej 15 000 eurosh apo më shumë, kryesi dënohet me gjebë dhe me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet".

Në rastet kur vepra e tekalon shumën prej 50 000 eurosh, dënim përvëç me gjebë, është edhe me burgim deri në tetë vjet. Për shmanjë nga tatimi, parashihen dënimet me gjebë dhe me burgim deri në katër vjet, varësish nga shuma e përdorur.

Për shembull, nëse tekalohet shuma prej 15 000 eurosh, parashihet dëni i gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim, ndërsa për shumën prej 50 000 euro parashihet dëni, përvëç me gjebë, edhe me burgim një deri në tetë vjet.

Rritet tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit

Prishtinë, 11 janar- Agjencja e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat afatshkurtra të tregtisë me pakicë përmes postës ose internetit. Në muajin tjetor 2023, indeksi i qarkullimit të tregtisë me pakicë kishte rritje më të madhe te tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara (43,2%); Tregtia me pakicë jo në dyqane (përmes postës ose internetit) (31,1%), krahasuar me muajin

e njëjtë të viti paraprak (tetor 2022).

Ndërsa rënie kishte te tregtia me pakicë e karburantit përmes postës ose internetit (-14,09%); Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara (-13,32%), krahasuar me muajin e njëjtë të viti paraprak (Tetor 2022).

Në muajin tjetor 2023, indeksi i numrit të punësuarve kishte rritje më të madhe te:



Të panjohurat e mëdha

Shumë pyetje të rëndësishme kanë mbetur pa përgjigje. Disa shkencëtarë i përgjigjen një pyetjeje: cila është ajo gjë që do të doje ta dije për planetin, që mbetet mister?



Sa specie ka në Tokë?

“Me sa lloje kafshësh e ndajmë planetin? Vlerësimet variojnë nga 3 milionë deri në 100 milionë, dhe nuk ka shumë shenja që po konvergojmë në një përgjigje unike.”

Prof Andy Purvis është studiues në Muzeun e Historisë Natyrore

Do të kthehesha 540 milion vjet mbrapa për të parë ‘Big Bang-un biologjik’

“Si një biolog evolucionar, do të më pëlqente që një makinë kohe të më kthente në shpërthimin Kambrian [kur shumica e grupeve kryesore të kafshëve u shfaqën për herë të parë në të dhënat fosile], sepse kjo periudhë e shkurtër rezultoi në ngritjen vërtet të shpejtë të shumicës së grupeve të kafshëve, dhe pse disa prej tyre, si për shembull trilobitet [artropodët e zhdukur detarë], nuk mbijetuan.”

Biologu evolucionar Dr Corrie Moreau është ekspert përmilagonat në laboratorin Moreau të Universitetit Cornell

A mund të ndihmojnë disa nga format më të vogla të jetës, në shbangjen e krizës klimatike?

“Ashtu si ne njerëzit mbështetemi te mikrobiomat e zorrëve për një shëndet të mirë të tretjes, papastërtia nën këmbët

tona përmban një numër të panumërt bakteresh, kërpudhash dhe virusesh që ndikojnë në shëndetin e Tokës dhe të bimëve që iriten në të. Sepse shumica e këtyre organizmave nuk mund të kultivoohen në laborator, dhe dimë shumë pak për ekologjinë e tyre. Megjithatë, prania e mikrobeve të caktuara mund t'i ndihmojë pemët të rriten deri në tre herë më shpejt. A mund të janë aleatë këta ‘mikrobe të mira’, në luftimin e ndryshimeve klimatike dhe promovimin e sigurisë ushqimore?”

Dr Bonnie Waring është një pedagoqe e lartë në Institutin Grantham të Kolegit Imperial në Londër.

Cili është biodiversiteti i plotë i pyjeve tropikale të pellgut të Amazonës ose Kongos?

“Do të doja të kuptoja diversitetin e plotë në një zonë të vogël të pyjeve tropikale – si 100 me 100 metra: sa specie jetojnë ose kalojnë atje, ndërveprimet e tyre me njëra-tjetrën, sa të vjetër janë, nga kanë ardhur. Përveç njojurive shkencore që kjo do të na ofronte, shpresoj se do të ndihmonë për të bindur njerëzit për kompleksitetin dhe vlerën ekstreme të ekosistemeve të mbledhura gjatë mijëvjeçarëve – dhe se mbrojtja e asaj që na ka mbetur është gjithmonë një zgjedhje më e mirë, sesa shkatërrimi dhe përpjekja për ta

rivendosur më vonë.”

Prof Alexandre Antonelli është drejtor i shkencës në Kopshtin Botanik Mbretëror, Kew

Si ndikojnë kafshët në Tokë?

“Si e formojnë kafshët pamjen dhe funksionin e ekosistemeve? Ne e dimë se ato veprojnë në disa mënyra të mirëpublikuara, të tilla si pjalmimi ose shpërndarja e farave, por ka shumë mënyra delikate – të tilla si cikli i lëndëve ushqyese, ngrënia selektive e bimëve, rrjetet e ndërlikuara të grabitqarëve dhe gjahut – që janë kuptuar keq, por vazhdimisht na befasojnë. Vetëm muajin e kaluar, mësova se merimangat përcaktojnë se ku rriten bimët dhe ekosistemet shërohen pas një shpërthimi vullkanik, duke kapur fara në rrjetat e tyre. Dhe në fund të fundit, sa ndikon kjo kafshë me rëndësi në biomën apo materien në nivel global? Sa shumë kafshët i jasin formë funksionimit të planetit Tokë?”

Yadvinder Malhi është profesor i shkencës së ekosistemeve në Universitetin e Oksfordit

Çfarë do të ndodhë me Rrymën e Gjirit (Gulf Stream)?

“Nëse do të më duhej të dija një gjë që është e pasigurt, është nëse do ndodhë, dhe nëse po, kur Rrjedha e Gjirit do të mbyllët

papritur, duke ndryshuar plotësisht klimën e Evropës, duke shkaktuar një rënie drastike të temperaturave – me ndikime potencialisht katastrofike në sigurinë e ujit dhe ushqimit – ndërsa pjesa tjetër e planetit pietet për shkak të ndryshimeve klimatike.”

Sir Robert Watson është një nga shkencëtarët më të shquar të klimës në Mbretërinë e Bashkuar

A caktojnë rregullat universale se si evoluojnë bimët dhe kafshët?

“Organizmat me prejardhje shumë të ndryshme (duke përfshirë kafshët dhe bimët) duket se ndjekin një numër të kufizuar “stilesh” të përgjithshme. Cilat janë rregullat e përgjithshme që rregullojnë mënyrën se si ato janë ‘bashkuar’ dhe çfarë i bën disa stile shumë më të sukseshtme në Tokë se të tjerët? Nëse ekzistonjë rregulla të tillë, a janë të njëjtë për kafshët dhe bimët?”

Sandra Myrna Diaz është profesoreshë e ekologjisë në Universitetin Kombëtar të Kordobës, Argjentinë

Sa njerëz mund të përballojë Toka?

“Me ritmin aktual, do të duhen vetëm 10 vjet për të shtuar 1 miliard njerëz të tjerë në planet.

Tashmë jemi dëshmitarë të ndikimit shkatërrues të rritjes së paqëndrueshme të popullsisë. Nëse do të jetojmë në ekilibër, shëndet dhe harmoni me natyrën, sa njerëz të tjerë do të mund të strehojë Toka?”

Dr Gladys Kalema-Zikusoka ishte veterinerja e parë e kafshëve të egra në Ugandë dhe është një pioniere e konservimit

Cilat specie do t'i përshtaten krizës klimatike?

“Cilët janë kufijtë e përshtatjes së specieve dhe pse? Ne e dimë se klima po ndryshon dhe speciet po përshtaten, por nuk e kuptojmë se cilët janë kufijtë dhe pse ndryshojnë. Cilat specie do të dështojnë të përshtaten mjaft shpejt dhe në cilën pikë? Kush do të përshtatet dhe do të lulëzojë – dhe çfarë i përcakton këto përgjigje? Çfarë mund të bëjmë ne si shoqëri për të ndihmuar speciet të përshtatën? Këto janë pyetje themelore, përgjigjet e të cilave do të përcaktojnë se si do duket bota natyrore në të ardhmen, por të cilat gjithashtu ofrojnë njohuri të thella se si funksionon dhe evoluon biologjia.”

Sir Patrick Vallance është ish-këshilltari kryesor shkencor i qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe kryetar i bordit të Muzeut të Historisë Natyrore (bota.al)



Ramaj refuzon Kosovën dhe Shqipërinë, pret ftesë nga Gjermania



AMSTERDAM, 11 JANAR - Portieri i Ajaxit, Diant Ramaj, ka treguar se ka lënë në pritje ofertat nga Përfaqësuesja e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë, pasi shpreson në një ftesë nga Kombëtarja e Gjermanisë. Mediumi holandez Het Parool, me bazë në Amsterdam, ka bërë një intervistë të gjatë me portierin me prejardhje nga Kosova, Diant Ramaj, i cili po shkëlqen këtë sezoni me gjigantin evropian, Ajaxin. Megjithatë, për mediet shqiptare fokusi i intervistës padyshim se është ajo qfarë 22-vjeçari ka thënë për karrierën e tij ndërkombe. Sipas mediumit Het Parool, Ramaj ka luksin të jetë në gjendje ta zgjedhë njëren nga tri shtetet si përfaqësues. Madje ai ka rezervuar ftesa nga Kosova

dhe Shqipëria, pasi shpreson në një thirrje nga Die Mannschaft. "Më duhet të bëj një zgjedhje, por nuk dua ta bëj shumë shpejt. Kosova dhe Shqipëria tashmë më janë afroar. Thashë se më duhet kohë, edhe sepse shpresoj dhe pres Gjermaninë", ka thënë Ramaj, i cili tashmë ka luajtur për ekipet e moshave të Gjermanisë. Ramaj e di se Gjermania ka portierë me përvojë si Manuel Neuer, Marc-Andre ter Stegen dhe Kevin Trapp, por mendon se mund të ftohet. "Por portierët e Gjermanisë janë mbi tridhjetë vjeç. Kur shikoj vendet e tjera, ka një portier të ri kudo. Shikoni Bart Verbruggen në Holandë. Nuk po them se duhet të shkoj si portier i parë atje, por është mirë që edhe Gjermania të

thërrasë një të ri dhe t'i tregojë botës se një brez i ri po vjen", ka deklaruar ai. "Në këtë moshë unë jam portier për një klub të madh. Ajaxi nuk është në formën më të mirë tani, por po ndërton përsëri diçka për t'i ringjallur kohët e vjetra të suksesit. Pak portierë të rinj kanë mundësinë të luajnë për një klub kaq të madh dhe të fitojnë përvojë", ka pohuar Ramaj. "Ndoshta pres kot! Nga ana tjetër nuk dëshiron të zbulosh më vonë se mund të ishe portier i Gjermanisë. Zemra ime rreh për të dyja palët: Shqipërinë dhe Kosovën e shoh si atdheun tim, por jam lindur dhe rritur në Gjermani. Kjo nuk është absolutisht e lehtë", ka përfunduar 22-vjeçari.

Ndeshjet e Kupës në basketboll zhvillohen në Gjakovë

GJAKOVË, 11 JANAR - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), duke u bazuar në kompetencat e statutit, ka marrë vendim që Final 8 i Kupës së Kosovës të organizohet nga KB Vëllaznimi. Njëherësh Bordi i FBK-së udhëzon KB Vëllaznimin t'i fillojë përgatitjet e nevojshme në përputhje të Udhëzuesit për

Organizimin e Final 8 Kupës së Kosovës dhe akteve të tjera normative të FBK-së. Final 8 i Kupës së Kosovës do të organizohet nga 13 deri më 17 shkurt në qytetin e Gjakovës. Në Final 8 do të garojnë tetë skuadrat e elitës së basketbollit si dhe finalja në konkurrencën e femrave. Në Ditën e Pavarësisë

së Kosovës, më 17 Shkurt, do të organizohen tri finale: e Kupës së Ligës së Parë, e Femrave dhe e Meshkujve. Në Gjakovë për pesë ditë do të ketë spektakël të basketbollit, me finalet që pritet të jetë të jashtëzakonshme. Atmosfera në "Shani Nushi" ka qenë fantastike dhe kështu pritet të jetë edhe gjatë Final 8.

SHKURT

Gjilani konfirmon largimin e Bejtullait dhe Nafiu

Skuadra e Gjilanit ka njoftuar se e ka përfunduar bashkëpunimin me futbollistët Egzon Bejtullai dhe Valmir Nafiu. "Skifterat" njoftojnë se ndarja vjen pas një marrëveshjeje të dyanshme. "Klubi i falënderon Egzon Bejtullain dhe Valmir Nafiuin për kontributin e dhënë në fanellën kuqebardh, duke u uruar suksese të mëtutjeshme në sfidat e ardhshme. Faleminderit përmomentet e bukuria dhe angazhimin në klubin tonë!", ka njoftuar klubit gjilanas.

Mulaj largohet nga Trepça '89

Futbollisti Erblind Mulaj në "Facebook" ka njoftuar se ka ndërprerë kontratën me skuadrën e Trepçës '89. Ai ka falënderuar drejtuesit e klubit, shtabin teknik dhe bashkëlojtarët. "Pas gjysme sezoni të kaluara te KF Trepça '89 dua t'ju informoj se për arsy personale kemi ndërprerë kontratën me konsensus bashkëpunimi. Falënderoj presidentin Abedin Zeka bashkëlojtarët dhe shtabin teknik. Klubit i uroj suksese në vazhdim", ka shkruar Mulaj.

Për 100 mijë euro dështoi transferimi i Gashijanit te Hajduku

Sulmuesi i ri i Llapit, Elvir Gashijani, ishte afër nënshkrimit me Hajdukun e Splitit, por duket se çështja ka ngecur shkaku i financave. Hajduku raportohet se ka ofruar 200 mijë euro për 17-vjeçarin, por Llapit ka kërkuar 300 mijë euro, raporton gazeta kroate "Slobodna Dalmacija". Gashijani është anëtar i Përfaqësueses së Kosovës U19 dhe këtë sezoni ka zhvilluar 13 paraqitje me Llapin në Superligën e Kosovës në të cilat ka shënuar dy gola dhe ka shtuar një asistim. Ai ka shënuar edhe dy gola përmes kombëtaren në ndeshjen kundër kombëtares U19 të Ukrainës. Sipas Transfermarkt, vlera e tij në treg është 125 mijë euro.

Kosova bëri hapin e rëndësishëm drejt fazës tjetër

Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll ka fituar ndaj Britanisë së Madhe me rezultatin 30:22. Pjesa e parë ishte më e barabartë, ndërsa Kosova ka pasur telashe të dalë në lojën më të mirë të saj. Rezultati pas 30 minutave ishte 13:11. Paraqitja e Kosovës në pjesën e dytë ishte shumë më e mirë. U krijuar epërsi deri në 13 gola, ndërsa në fund britanikët u afroan në tetë gola. Tjetër fitore synohet të shtunën prej orës 14:00 në Derby të Anglisë, kur pritet të konfirmohet kualifikimi në fazën e ardhshme të eliminatoreve për "Euro 2026". Kapiteni Valon Dedaj ka udhëhequr Kosovën me 11 gola nga 16 tentime. 11 pritej i kishte portieri Haris Berisha, ndërsa shtatë gola i shënoi Kushtrim Ninaj. Nga katër gola shënuan Matej Thaqi e Arbios Mushkolaj.



9 minuta tmerri për Gambian në ajër, avioni nuk kishte oksigjen

BANJUL, 11 JANAR - Kombëtarja e Gambias ka përfjetuar momente tmerri para nisjes së Kupës së Kombeve të Afrikës. Futbollistët dhe i gjithë stafi u nisën me avion nga kryeqyteti i vendit, Banjul, drejt Bregut të Fildishtë. Vetëm 9 minuta pas shkëputjes

nga pista, piloti vendosi të rikthejë sërisht, pasi mungonte oksigjeni në bordin e avionit. Në një postim në "Instagram", ish-futbollisti i Manchester United, Saidy Janko, ka shkruar se shumë futbollistë patën dhimbje të forta të kokës

dhe marramendje ekstreme. Ndërkohë, trajneri belg i Gambias, Tom Saintfiet, ka shkruar: "Ne të gjithë mund të kishim vdekur. Të gjithëve na zuri gjumi brenda pak minutave. Unë po përfjetojë vegime për jetën time. Pas 9

minutash piloti vendosi të riktheheshim në pistë sepse nuk kishte furnizim me oksigjen. Disa lojtarë ishin në gjumë kur u rikthyem në pistë. Nëse do të qëndronim edhe pak në ajër, do të kishim vdekur të gjithë. Unë jam i gatshëm të vdes në fushën e lojës për futbollin, por jo në ajër".



Ish-trajneri i Anglisë: Jam me kancer, më ka mbetur vetëm edhe një vit jetë

STOKHOLM, 11 JANAR - Ish-trajneri i Anglisë, Sven-Goran Eriksson, ka thënë se ai është diagnostikuar me kancer dhe se në skenarin më të mirë të mundshëm, ai ka vetëm edhe një vit jetë. 75-vjeçari e çoi Anglinë në finalet e Kupës së Botës në 2002 dhe 2006, duke humbur në çerekfinale në të dy rastet, si dhe në "Euro 2004". Ai drejtoi ekipe si Benfica, Roma dhe Manchester City gjatë karrierës së tij prej katër dekadave. Në shkurt të vitit të kaluar ai u largua nga roli i tij në klubin suedez Karlstad për shkak të "çështjeve shëndetësore". "Të gjithë mund të shohin se unë kam një sëmundje që nuk është e mirë dhe të gjithë supozojnë se është kancer, dhe është. Por unë duhet ta luftoj atë sa më gjatë që të jetë e mundur", ka thënë Erikssoni



në një paraqitje në "Radio P1" suedeze. "Unë e di që në rastin më të mirë është rrëth një vit, në rastin më të keq edhe më pak. Ose në rastin më të mirë mendoj edhe më gjatë. Unë nuk mendoj se mjekët që kam mund të jenë plotësisht të sigurt. Është më

mirë të mos mendosh për këtë. Ju duhet ta mashtroni trurin tuaj. Unë mund të shkoj duke menduar për këtë gjatë gjithë kohës dhe të ulem në shtëpi dhe të jesh i mjeruar dhe të mendosh se jam i pafat dhe kështu me radhë", ka deklaruar Erikssoni.

Bostoni fiton sfidën e kryesuesve, humbasin Golden State, Miami dhe Denveri



BOSTON, 11 JANAR - Denveri fitoi me rezultat 127-120 ndaj Minnesotas në përballjen mes dy skuadrave që kryesojnë konferencat përkatëse. Fitore e merituar e Celticsit, ku u dalluan Tatumi me 45 pikë e

Browni me 35 pikë e 11 rebounde. Humbet ekipi kampion i Denverit, që u mund me shifrat 124-111 nga Utah Jazzi. Clarkson e Markkaneni realizuan 53 pikë së bashku për Jazzin, duke i bërë të pavlefshme 27

pikët e Jokiqit përmirësuar. Vilon kriza e Golden States, që u mund thellë me rezultat 141-105 në fushën e tij nga New Orleansi, duke dalë edhe nga zona "play-out". Tetë lojtarë të ekipit mik realizuan mbi 10 pikë, ndërsa për Warriorsin mungoi lojtari lider. Zhgënje edhe Miami, që u mund me rezultat 128-120 nga Oklahoma, që falë këtij triumfi, ngjitet në vendin e dytë në Perëndim. Shai me 28 pikë u dallua për Oklahoman. Fituan edhe clippersat, 126-210 ndaj Torontos, ndeshje ku u dalluan Leonard e George me nga 29 pikë secili.

REZULTATET

Boston - Minnesota	127-120
Charlotte - Sacramento	98-123
Detroit - San Antonio	108-130
Indiana - Washington	112-104
Atlanta - Philadelphia	139-132
Miami - Oklahoma	120-128
Chicago - Houston	124-119
Golden State - New Orleans	105-141
Utah Jazz - Denver	124-111
Clippers - Toronto	126-120

Ancelotti: Përbysjet janë pjesë e AND-së së Realit

Real Madridi shkoi në finalen e Superkupës së Spanjës pas fitores 5-3 ndaj Atletico Madridit në derbin e luajtur në Riad të Arabisë Saudite. Një ndeshje e vendosur pas 120 minutave shtesë, ku dy herë "los blancos" përbysyi disavantazhin e

"colchoneros", për të arritur një fitore të madhe. "Uroj që kjo ndeshje t'u shërbejë më të rinxve. Mund të humbasësh, por kurrë nuk duhet hequr dorë", ka thënë Ancelotti. "Duhen ende edhe katër ditë derinë finale, por tensioni në këtë ndeshje

ishte i tmerrshëm. Një ndeshje e dueluar fort, mes dy ekipes që luftuan fort. Mendoj se ishte një ndeshje spektakli për futbollin. Fituan pasi patëm më shumë energji në fundin e ndeshjes", ka shtuar ai. "Fituan ata që hynë si

zëvendësues, Joselu, Brahim, Ceballos. Kjo i jep shumë besim një trajneri, pasi sheh se e gjithë skuadra është e motivuar. Vetëm kështu mund të fitohen këto takime", ka deklaruar Ancelotti. Problem për Realin janë golat e shumtë të pësuar:

"Më shqetësojnë, pasi duhet të përmirësohem. Gjithsesi, jemi të qetë edhe pse duhen ende 90 minuta për ta fituar trofeun. Përbysjet? Nuk ka asnjë të re për mua. Mendoj se kjo është pjesë e AND-së së Real Madridit".

SHKURT

Hamiltoni: Kam thënë se jam i sëmurë për të mos marrë pjesë në teste

Piloti britanik i Mercedesit, Lewis Hamilton, që sapo ka mbushur 39 vjeç, është piloti më i suksesshëm në historinë e Formulës 1, me 103 fitore. Gjithsesi, ka diçka në këtë sport që 7 herë kampioni i botës nuk e pëlqen: testet. Dikur pilotët mund të zhvillonin mjaft ditë teste në prag të sezzonit, ndërsa tani ato janë reduktuar në disa orë. E, megjithatë, Hamiltoni do të dëshironë që ato të mos ekzistonin fare, apo të zgjasnin shumë më pak. Sipas "Race Fans", Hamiltoni ka deklaruar se shpesh ka mashtruar për të evitar të merrte pjesë në teste. "Në të shkuanë kam bërë sikur kam qenë i sëmurë për të mos marrë pjesë në disa teste", rrëfen britaniku. "Në përgjithësi, nuk më pëlqejnë ditët e provave. Një ditë, kur mësova se George nuk do të merrte pjesë në teste se ishte i sëmurë, mendova se ma hodhi, por ai ishte vërtet i sëmurë. Do të pëlqejë sa më pak teste ose aspak", ka deklaruar Hamiltoni.

Griezmanni bëhet golashënesi më i mirë në histori të Atleticos

Sulmuesi Antoine Griezmann e ka thyer rekordin e legjendës Luis Aragones, duke u bërë golashënesi më i mirë në histori të klubit të Atletico Madridit. Atletico pësoi humbje me rezultat 5-3 (3-3) nga Real Madridi në gjysmëfinalen e zhvilluar në Arabinë Saudite në kuadër të Superkupës së Spanjës. Megjithatë, edhe pse ishte një natë zhgënje për "Los Rojiblancos", një pikë e ndritur ishte goli i bukur i shënuar nga Griezmanni. Ky gol ishte i 174-ti i frantezit Griezmann për klubin kryeqytetas, i cili e vendosi atë përparrë Luis Aragones (173) si golashënesi më i mirë në historinë e Atleticos. "Është diçka e pabesueshme për mua, një burim i madh krenarie. Në pjesën e parë kishte shumë emocione, por ne duhej të ktheheshim në lojë", ka thënë Griezmanni.

Xavi vendos, këta futbollistë largohen nga Barça

Xavi Hernandez është duke bërë hapa të rendësishëm drejt ndërtimit të një skuadre të re dhe të fuqishme për sezzonin e ardhshëm në Barcelona. Në përpjekjen për ta realizuar vizionin e tij për futbollin, raportohet se ai ka planifikuar largimin e disa lojtarëve të njohur. Emrat që janë në rrezik të largohen nga Barcelona përfshijnë Joao Felix, i cili, megjithëse ka mbështetjet e presidentit, duket se nuk ka mbështetin e Xavit. Ansu Fati, një talent i akademisë, mund të përfshihet në një marrëveshje të rendësishme financiare gjatë verës. Në përpjekje për ta forcuar mbrojtjen, Xavi ka shprehur dëshirën për ta mbajtur Joao Cancelo. Sergino Dest, ndërkohë, mund të largohet në një klub tjeter. Në mesfushë, Xavi synon të sjellë një mesfushor mbrojtës më të profilizuar, duke vendosur në rrezik vendin e Oriol Romeut. Dy lojtarët e tjerë që pritet të largohen janë Marcos Alonso dhe Clement Lenglet.



MITROVICA
KOMPANIJA UJESJELLEŠI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D P A
Departamenti për punë administrative

Mitrovicë 12.01.24 / Nr. 43

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë këtë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj me mundesi vazhdimi)

I.Pozita e punës: Drejtor Komercial.

Kompania: Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë.
Paga bazë: 991.25 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Kushtet për punësim (edukimi i kërkuar):

Përgatitja profesionale: Titulli "Master", në drejtimet (Ekonomik, Menaxhment, Administrim Biznesi).

Përvjetore e punës: Tri (3) vite përvjetore pune, prej tyre së paku dy (2) vite punë menaxheriale
Pozita e hapur: Një (1) Drejtor Komercial.

Kushtet e veçanta:

- ✓ Njohuri të larta të raportimit të performancës dhe proceseve financiare/buxhetore,
- ✓ Të jetë shumë i orientuar drejt qëllimeve dhe zotëroj aftësi të shkëlqyera ndër personale dhe komunikuese,
- ✓ Aftësi të shkëlqyera organizative dhe udhëheqjes,
- ✓ Njoha e punës me kompjuter, programe softuerike (aplikacione) që funksionojnë në kuadër të Ndërmarrjes.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Drejton, organizon dhe zbaton punët dhe detyrat e caktuara në kompani në Departamentin Komercial si dhe të Marrëdhënies me konsumatorët dhe çështjet specifike (Faturimi, Inspektimi),
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive,
- Drejton dhe përgatit të dhënat komerciale të kompanisë për planin e biznesit,
- Shqyrton dhe aplikon procedurat e aprova rëtë sektorin komercial,
- Koordinon, kontakton dhe bashkëpunon në ofrimin e të gjitha të dhënavë te aktivitetit te departamentit ne varësi,
- Analizon klimën e treguesve dhe tendencat e biznesit ne aspektin komercial për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen,
- Interpretion informacionin sektorial për të siguruar raportet e nevojshme përvendim-marrje,
- Monitoron procesin e faturimit dhe shitjeve, nivelin e përfornancës në njësit vartëse, llogaritë e arkëtueshme,
- Sipas autorizimeve të KE-së përfaqëson Ndërmarrjen përparrë palëve të interesit,
- Sipas kërkësave përpilon raporte mujore dhe vjetore për ARRUM dñe institucionë veritarë,
- Është pjesë ndërlidhëse midis departamentit dhe njësitet e tjera,
- Kryen detyra të tjera, me ZKF-ne koordinon aktivitetet rreth mirëmbajtjes se llogarive te arkëtueshme dhe kryen detyra të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv, sipas fushës së kompetencës dhe pozitës,
- Për punën që e kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Dokumentet e kërkuar:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Një deklaratë nën betim (për pozitën: Drejtor Komercial).
- Kopja e letërnjoftimit.

Aplikacionet mund të merrin ueb-faqën e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.a. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, si dhe në zyrën për burime njerëzore dhe të dorëzohen në të njëjtën zyre së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.

Konkursi do t'jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data 12.01.2024 deri me datën 26.01.2024.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato t'ë mangëta refuzohen.

Dokumentet e pranuara t'ë aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatet nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuar t'ë aplikojnë.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë.



MITROVICA
KOMPANIJA UJESJELLEŠI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D A P

Departament za Administrativne Poslove

Mitrovica 12.01.24 Br 43

Na osnovu Administrativnog uputstva br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće "Mitrovica" d.d. u Mitrovici, objavljuje:

K O N K U R S

(Za popunjavanje radnih mesta probni rad u trajanju od šest (6) meseci, sa mogućnošću produženja)

I. Radno mesto: Komercijalni Direktor.

Kompanija: Regionalna Kompanija Vodovod „Mitrovica“ D.D. u Mitrovici.

Osnovna plata që biće 991.25 Euro po uredbi o raspodeli prihoda.

Uslovi za zapošljavanje (potrebno obrazovanje)

Stručna spremă: Maester (Ekonomija, Menadžment, Poslovna Administracija)

Radno iskustvo: 3 godina radnog iskustva, od kojih najmanje 2 godine menadžerski

Otvorena pozicija: Jedan (1) Komercijalni Direktor.
posebni uslovi;

- ✓ Visoko poznavanje izveštavanja performanse i finansijskih/budžetskih procesa,
- ✓ Da bude veoma orijantisan ka cilju i imati odlične međuljudske komunikacijske veštine,
- ✓ Odlične organizacione i rukovodeće sposobnosti,
- ✓ Poznavanje rada sa kompjuterom, softverskim programima (aplikacije) koje funkcionišu u okviru Preduzeća.

Radne obaveze i odgovornosti:

- Da bude sposoban/na za obavljanje radnih obaveza sa punim radnim vremenom i bez ograničenja,
- Da usmerava, organizuje i realizuje poslove i zadatke u preduzeću u Sektoru Komercijale, kao i donose sa potrošačima i specifična pitanja (fakturisanje, inspekcija sa potrošačima),
- Da vodi i savetuje svoj podređeno osoblje kako bi osigurali efektivne rezultate,
- Da upravlja i pripremi komercijalne podatke kompanije za poslovni plan,
- Da pregledai procenjuje odobrene procedure za komercijalni sektor,
- Da koordinira, kontaktira i sarađuje u pružanju svih podataka o aktivnostima pdređenog deljenja,
- Da analizira komercijalnu klimu i poslovne trendove marketinških stručnjaka kao bi pomogli višim rukovodicima u kreiranju strateških planova za budućnost,
- da tumači sektorske informacije kako bi obezbedio neophodne izveštaje za donošenje odluka,
- Da prati proces fakturisanja i prdaje, nivo učinka u podređenim jedinicama, potraživanja,
- Da po ovlašćenjima EK zastupa Preduzeće pred zainteresovanim strankama,
- Da prema zahtevima izradi mesečne i godišnje izveštaje za ARRUM i vladinih institucija,
- Da je deo za vezu između deljenja i drugih jedinica,
- Da izvrši druge zadatke, sa ZKF koordinira aktivnosti oko održavanja potraživanja i da završi određene zadatke od strane glavnog Izvršnog Direktora, prema oblasti nadležnosti i položaju,
- Za poslove koje izvršava odgovara izvršnom Direktoru.

Traženi dokumenti:

Zainteresovani kandidati moraju da popune prijavu Kompanije i da uz ovu prijavu prilože sledeću dokumentaciju:


- CV (biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitska diploma (overena kopija, dok diplome sa univerzitetu u inostranstvu moraju biti overene kod notara),
- Dokaz nadležnog suda koji nije pod istragom, koji važi najviše 6 meseci,
- Dokaz o stručnoj obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Izjava pod zakletvom (za poziciju: komercijalni direktor),
- Kopija lične karte,

Prijave se primaju na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/> kao i u kancelariji za ljudske resurse i dostavlja se istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom.

Konkurs će biti ovoren 15 dana od dana objavljinja u sredstvima informisanja pocevsi od dana 12.01.2024 do 26.01.2024.

Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju.

Prihvaćena fotokopirana dokumenta podnosiocima prijava se ne vraćaju. Regionalno vodovodnopreduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave. RVP „Mitrovica“ d.d. Mitrovica.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Mat Group" SH.P.K. me pronar Besian Hyseni Kamenicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810327842 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Mat Group" D.O.O. sa vllasnikom Besian Hyseni Kamenice, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810327842 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Mat Group" L.L.C. with owner Besian Hyseni Kamenice, has come to the decision to quit its business: 810327842 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[facebook](#)

www.facebook.com/gjejpuneshpeje

RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Albropa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Africa Balkans Trade And Culture Centre" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 811896911.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Gëzim Kollçaku shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Juridik të UP-së, Prishtinë.
- Leutrim Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Elvira Gojani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomë e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Astrit Jusufi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Bledar Topalli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershorë deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

